

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara

SKK 8 TË ARDHURAT

Pg.	
	STANDARDI KOMBËTAR I KONTABILITETIT NR. 8 – TË ARDHURAT – I PËRMIRËSUAR
	PËRMBAJTJA <i>Paragrafët</i>
	OBJEKTIVI DHE BAZA E PËRGATITJES 1-3
	FUSHA E ZBATIMIT 4-5
	PËRKUFIZIMET KRYESORE 6-7
	NJOHJA E TË ARDHURAVE 8
	MATJA E TË ARDHURAVE 9-13
	IDENTIFIKIMI I TRANSAKSIONIT 14-15
	SHITJA E MALLRAVE DHE E PRODUKTEVE 16-19
	KRYERJA E SHËRBIMEVE 20-43
	Kontratat e shërbimit 20-23
	Kontratat e ndërtimit 24-27
	Metoda e fazës së përfundimit 28-34
	Të ardhurat nga kontratat e shërbimeve dhe të ndërtimit 35-39
	Kostot nga kontratat e shërbimeve dhe të ndërtimit 40-43
	INTERESAT, TË ARDHURAT NGA PËRDORIMI I PRONËS DHE DIVIDENDËT 44-45
	PARAQITJA NË PASQYRËN E POZICIONIT FINANCIAR DHE NË PASQYRËN E PERFORMANËS 46-47
	SHËNIMET SHPJEGUESE 48-49
	DATA E HYRJES NË ZBATIM 50
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITË E VOGLA DHE TË MESME 51
	BAZA E KONKLUZIONEVE
	UDHËZUES PËR ZBATIMIN E SKK 8
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 8, <i>Të ardhurat</i> (‘SKK 8’ ose ‘Standardi’), nxjerrë dhe miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministria e Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëposhëm në lidhje me të ardhurat nga shitja e mallrave, shërbimeve, interesat, dividendët, shfrytëzimi i pronës dhe kontratat e ndërtimit, në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Këto standarde bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimit, të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme, të të cilave jepen në Ligjin nr. 9228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar.
2	SKK 8 mbështetet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit, SNK 11, <i>Kontratat e ndërtimit</i> dhe SNK 18, <i>Të ardhurat</i> . SKK 8 është ndryshuar për t’u bërë i krahasueshëm me Seksionin 23 – <i>Të ardhurat të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar</i>

	<p><i>për Njësitë Ekonomike të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM).</i> Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM-të është dhënë në paragrafin 51. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 8 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare , ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare dhe të kapitalit të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin 9 të Ligjit nr. 9 228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar.</p>
3	<p>Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat jomaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 40 deri 90 të SKK 1.</p>
	<p>FUSHA E ZBATIMIT</p>
4	<p>Ky standard zbatohet për kontabilizimin e të ardhurave që vijnë nga veprimet dhe ngjarjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) shitja e produkteve dhe mallrave; (b) kryerja e shërbimeve; (c) kontratat e ndërtimit në të cilat njësia ekonomike është ndërtuesi; (d) përdorimi i aktiveve të njësisë ekonomike nga palë të treta, nga ku gjenerohen të ardhura nga interesi, të ardhura nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëllti), dhe të ardhura nga dividendët.
5	<p>Ky standard nuk trajton të ardhurat që vijnë nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) marrëveshjet e qirasë financiare (shih SKK 7 <i>Kontabilizimi i qirave</i>); (b) dividendët nga investime në pjesëmarrje dhe njësitë e kontrolluara, të cilët kontabilizohen me metodën e kapitalit neto ose nëpërmjet konsolidimit (shih SKK 14 <i>Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta</i>); (c) ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare ose në vlerën e shitjes së tyre (shih SKK 3 <i>Instrumentet financiare</i>); (d) ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve afatgjata materiale të investuara (shih SKK 5 <i>Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale</i>); (e) njohja dhe ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve biologjike që lidhen me aktivitetin bujqësor dhe njohja e prodhimit bujqësor (shih SKK 13 <i>Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare</i>); (f) kontratat e sigurimit në njësitë ekonomike të sigurimit;
	<p>PËRKUFIZIMET KRYESORE</p>
6	<p>Më poshtë jepen përkufizimet e termave kryesore, të përdorura në këtë standard.</p> <p><u>Të ardhurat</u> janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit (këtu nuk përfshihen rritjet, që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital).</p> <p><u>Produkte</u> janë të mira të prodhuara nga njësia ekonomike me qëllim shitje.</p> <p><u>Mallra</u> janë të mira të blera nga njësia ekonomike me qëllim rishitje. Konsiderohen mallra dhe pronat të cilat mbahen për rishitje.</p> <p><u>E ardhura nga interesi</u> është një e ardhur që i takon njësisë ekonomike për përdorimin e parasë ose ekuivalentëve të saj nga palë të treta.</p> <p><u>E ardhura nga shfrytëzimi i pronësisë nga palë të treta (rojëllti)</u> janë të ardhurat që kanë të bëjnë me përdorimin e aktiveve afatgjata jomateriale të njësisë ekonomike nga palë të treta, të tilla si patenta, emri tregtar, të drejta të autorit dhe programe kompjuterike (softëare).</p> <p><u>Dividendët</u> janë shpërndarje e fitimit tek zotëruesit e instrumenteve të kapitalit (për shembull aksionet).</p> <p><u>Vlera e drejtë</u> është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim, në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes.</p>

	<p><u>Marrëveshja për kryerjen e shërbimeve</u> është një marrëveshje e lidhur mes palëve për kryerjen e një ose një sërë shërbimesh të ndërlidhura.</p> <p><u>Kontrata e ndërtimit</u> është një kontratë e nënshkruar për ndërtimin e një aktivi të caktuar ose disa aktiveve të kombinuara që janë të ndërlidhura ngushtë ose të ndërvarura midis tyre, përsa u përket projektimit, teknologjisë dhe funksionit, qëllimit final dhe përdorimit të tyre.</p>
7	<p>Një njësi ekonomike duhet të përfshijë në të ardhurat e saj vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të arkëtuara dhe për t'u arkëtuar për llogari të vet. Një njësi ekonomike duhet të përjashtojë nga të ardhurat të gjitha shumat e mbledhura në emër të palëve të treta të tilla si taksat e shitjes të mallrave dhe shërbimeve dhe tatimin mbi vlerën e shtuar. Në një marrëdhënie ndërmjetësie (agjenci), një njësi ekonomike do të përfshijë në të ardhurat vetëm shumën e komisioneve të saj. Shumat e mbledhura në emër të shoqërisë kryesore nuk janë të ardhura për njësinë.</p>
	NJOHJA E TË ARDHURAVE
8	<p>Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.</p>
	MATJA E TË ARDHURAVE
9	<p>Një njësi ekonomike duhet të masë të ardhurat me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.</p>
10	<p>Në shumicën e rasteve pagesat bëhen në parë. Kur paratë arkëtohen menjëherë ose do të arkëtohen shumë shpejt, pas kryerjes së transaksionit, të ardhurat nga shitja janë të barabarta me shumën e parave të arkëtuara ose të arkëtueshme.</p>
11	<p>Kur hyrja e mjeteve monetare ose e ekuivalentëve të mjeteve monetare është shtyrë në kohë, dhe rregullimi përbën në fakt një transaksion financiar, vlera e drejtë e shumës është vlera aktuale e të gjitha arkëtimit të ardhshme të përcaktuara, duke përdorur një normë interesi të përcaktuar. Një transaksion financimi lind kur, për shembull, një njësi ekonomike për shitjen e mallrave ofron kredi pa interes për blerësit ose pranon nga blerësi një dëftesë të arkëtueshme me një normë interesi nën nivelin e tregut. Norma e interesit e përcaktuar është norma që mund të përcaktohet më qartë mes:</p> <p>(a) normës së përgjithshme të një instrumenti të ngjashëm të një emetuesi me një rankim të ngjashëm kredie, apo</p> <p>(b) një norme interesi që skanton shumën nominale të instrumentit në vlerën aktuale të çmimit të shitjes së mallrave ose shërbimeve.</p> <p>Një njësi ekonomike duhet të njohë diferencën në mes vlerës aktuale të të gjitha hyrjeve të ardhshme dhe shumës nominale të të ardhurave nga interesi në përputhje me paragrafët 12 dhe 13 dhe SKK 3.</p>
12	<p>Një njësi ekonomike nuk do të njohë të ardhura:</p> <p>(a) kur mallrat ose shërbimet janë shkëmbyer për mallra ose shërbime të ngjashme në natyrë dhe vlerë, ose</p> <p>(b) kur mallrat ose shërbimet janë shkëmbyer për mallra ose shërbime jo të ngjashme, por transaksionit i mungon përmbajtja tregtare.</p>
13	<p>Një njësi ekonomike duhet të njohë të ardhurat kur mallrat ose shërbimet e shitura janë shkëmbyer për mallra ose shërbime jo të ngjashme në një transaksion që ka përmbajtje tregtare. Në këtë rast, njësi ekonomike do të masë transaksionin me:</p> <p>(a) vlerën e drejtë të mallrave ose shërbimeve të marra, e rregulluar për ndonjë shumë të transferuar të mjeteve monetare ose ekuivalentëve të tyre;</p> <p>(b) nëse shumat në pikën (a) nuk mund të maten në mënyrë të besueshme, atëherë do të maten me vlerën e drejtë të mallrave ose shërbimeve të dhëna të rregulluar për ndonjë shumë të transferuar të mjeteve monetare ose ekuivalentëve të tyre; ose</p> <p>(c) nëse vlera e drejtë qoftë e aktivitetit të marrë, apo e aktivitetit të dhënë nuk mund të maten në mënyrë të besueshme, atëherë do të maten me vlerën kontabël të aktivitetit të dhënë të rregulluar për ndonjë shumë të transferuar të mjeteve monetare ose ekuivalentëve të tyre .</p>
	IDENTIFIKIMI I TRANSAKSIONIT
14	<p>Një njësi ekonomike zakonisht zbaton kriteret e njohjes së të ardhurave për secilin transaksion më vete. Megjithatë, një njësi ekonomike zbaton kriteret e njohjes veçmas për çdo përbërës të identifikueshëm të një transaksioni të vetëm kur është e nevojshme që të pasqyrohet përmbajtja e transaksionit. Për shembull, një njësi ekonomike zbaton kriteret e njohjes për përbërësit e identifikueshëm veçmas të një transaksioni të vetëm, kur çmimi i shitjes së një produkti përfshin një shumë të identifikueshme për shërbimin e mëvonshëm. Anasjelltas, një njësi ekonomike zbaton kriteret e njohjes të dy ose më shumë transaksioneve së bashku,</p>

	kur ata janë të lidhur në mënyrë të tillë që efekti tregtar nuk mund të kuptohet pa iu referuar grupit të transaksioneve si një i vetëm. Për shembull, një njësi ekonomike zbaton kriteret e njohjes të dy ose më shumë transaksioneve së bashku kur shet mallra dhe në të njëjtën kohë, hyn në një marrëveshje të veçantë për riblerjen e mallrave në një datë të mëvonshme, duke mohuar efektin thelbësor të transaksionit.
15	Nganjëherë, si pjesë e një transaksioni shitjeje, një njësi ekonomike u jep blerësve të saj një bonus besnikërie që në të ardhmen të marrin mallra ose shërbime falas ose të përfitojnë zbritje në çmim. Në këtë rast, në përputhje me paragrafin 14, njësi ekonomike do ta trajtojë bonusin si një përbërës të veçantë të identifikueshëm të transaksionit fillestar të shitjes. Njësi ekonomike do të shpërndajë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar në lidhje me shitjen fillestare midis bonusit dhe përbërësve të tjerë të shitjes. Shuma e shpërndarë tek bonusi do të matet duke iu referuar vlerës së tij të drejtë, d.m.th. shumës me të cilën bonusi mund të shitet veçmas.
	SHITJA E MALLRAVE DHE E PRODUKTEVE
16	Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve do të njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> (a) njësi ekonomike ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; (b) njësi ekonomike nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe te produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; (c) shumata e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; (d) është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren nga njësi ekonomike; (e) kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.
17	Vlerësimi nëse një njësi ekonomike ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi, kërkon një analizë të rrethanave të transaksionit. Në shumicën e rasteve, kalimi i rreziqeve dhe i përfitimeve, në lidhje me pronësinë, tek blerësi, përputhet me kalimin e titullit ligjor (për shembull, në shitjet me pakicë ajo ndodh në kohën e dorëzimit të mallrave/produkteve tek blerësi; në rastin e shitjes me dorëzim pjesor, kalimi i titullit ligjor bëhet siç përshkruhet në marrëveshjen e dorëzimit pjesor). Në rrethana të caktuara kalimi i rreziqeve dhe i përfitimeve, që burojnë nga pronësia, nuk ndodh në të njëjtën kohë me kalimin e titullit ligjor.
18	Nëse rreziqet që lidhen me pronësinë nuk i kalojnë blerësit, atëherë të ardhurat nuk njihen, pavarësisht nga fakti nëse titulli ligjor i ka kaluar blerësit apo jo. Shembuj të situatave, ku rreziqet nuk i kanë kaluar blerësit dhe, si rrjedhim, të ardhurat nuk njihen nga njësi ekonomike, janë: <ul style="list-style-type: none"> (a) kur njësi ekonomike mbart një detyrim për rezultate jo të kënaqshme, që nuk mbulohet nga garancitë normale. (b) kur arkëtimi i të ardhurave nga një shitje e caktuar është i kushtëzuar nga gjenerimi i të ardhurave nga shitja e mëtejshme e këtyre mallrave apo produkteve nga ana e blerësit; (c) kur mallrat apo produktet transportohen e duhet të montohen, dhe montimi është një pjesë e rëndësishme e kontratës, i cili nuk është kryer akoma nga shitësi; (d) kur blerësi ka të drejtë ta anulojë blerjen, për arsye të përcaktuara në kontratën e shitjes, dhe shitësi është i pasigurt mbi mundësinë e kthimit apo moskthimit të mallit apo produktit.
19	Nëse njësi ekonomike mbart vetëm një rrezik të parëndësishëm, që lidhet me pronësinë, atëherë të ardhurat nga shitja njihen, edhe pse titulli ligjor nuk është kaluar. Shembuj të situatave të tilla janë: <ul style="list-style-type: none"> (a) blerësi ka të drejtë t'i kthejë mallrat apo produktet gjatë kohës së specifikuar në kontratë, dhe njësi ekonomike është në gjendje ta parashikojë mundësinë e kthimit, në bazë të përvojës së mëparshme. Në kohën e shitjes, njësi ekonomike i njeh të ardhurat nga shitja dhe krijon një provizion për mallrat apo produktet me mundësi kthimi; (b) titulli ligjor i mallrave apo produkteve të shitura mbahet nga njësi ekonomike si siguri për arkëtimin e shumës.
	KRYERJA E SHËRBIMEVE
	Kontratat e shërbimit
20	Kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e një shërbimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat e lidhura me transaksionin duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese (nganjëherë referuar si metoda e përqindjes së përfundimit).
21	Rezultati i një transaksioni mund të vlerësohet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> (a) shumata e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; (b) është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike; (c) faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri; (d) kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

22	Metoda e fazës së përfundimit përshkruhet në paragrafët 28-34.
23	Kur shërbimet kryhen përmes një numri të pacaktuar veprimesh gjatë një periudhe kohore të caktuar, një njësi ekonomike i njeh të ardhurat në bazë lineare përgjatë periudhës së caktuar me përjashtim të rastit kur ka evidencë që metoda të tjera përfaqësojnë më mirë fazën e përfundimit. Kur një veprim i caktuar është shumë më i rëndësishëm se çdo veprim tjetër, njësi ekonomike shtyn njohjen e të ardhurave deri sa veprimi i rëndësishëm të kryhet.
	Kontratat e ndërtimit
24	Kur rezultati i një kontrate ndërtimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat dhe kostot që lidhen me kontratën e ndërtimit si të ardhura dhe shpenzime përkatësisht duke iu referuar fazës së përfundimit të aktivitetit të kontratës në fund të periudhës raportuese (shpesh referohet si metoda e përqindjes së përfundimit). Vlerësimi i besueshëm i rezultatit kërkon vlerësime të besueshme të fazës së përfundimit, kostove të ardhshme dhe arkëtueshmërisë së faturave. Paragrafët 28 dhe 34 japin udhëzime në lidhje me metodën e përqindjes së përfundimit.
25	Kërkesat e këtij Standardi zakonisht zbatohen veças për çdo kontratë ndërtimi. Megjithatë, në disa rrethana, ky Standard është i nevojshëm të zbatohet për përbërësit e identifikueshëm të një kontrate të vetme ose për një grup kontratash së bashku në mënyrë që të pasqyrojë përmbajtjen e një kontrate ose të një grupi kontratash.
26	Kur një kontratë mbulon një numër aktivesh, ndërtimi i çdo aktivi do të trajtohet si një kontratë ndërtimi e veçantë kur: (a) për çdo aktiv janë paraqitur propozime të veçanta; (b) çdo aktiv ka qenë subjekt i negociatave të veçanta, si kontraktori dhe klienti janë në gjendje të pranojnë ose refuzojnë atë pjesë të kontratës që lidhet me çdo aktiv; dhe (c) kostot dhe të ardhurat e çdo aktivi mund të identifikohen.
27	Një grup kontratash, qoftë me një klient të vetëm ose me disa klientë, do të trajtohet si një kontratë ndërtimi e vetme kur: (a) grupi i kontratave është negociuar si një paketë e vetme; (b) kontratat janë të ndërlidhura kaq ngushtë saqë, në fakt, ato janë pjesë e një projekti të vetëm me një marzh fitimi të përgjithshëm; dhe (c) kontratat janë kryer njëkohësisht ose në mënyrë të njëpasnjëshme.
	Metoda e fazës së përfundimit
28	Kjo metodë përdoret për të njohur të ardhurat nga kryerja e shërbimeve dhe nga kontratat e ndërtimit. Një njësi ekonomike do të shqyrtojë dhe, kur është e nevojshme, rishikojë vlerësimet e të ardhurave dhe kostove kur transaksioni i shërbimit ose kontrata e ndërtimit është në zbatim e sipër.
29	Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë fazën e përfundimit të një transaksioni ose kontrate ndërtimi duke përdorur metodën që mat në mënyrë më të besueshme punën e kryer. Metodat e mundshme përfshijnë: (a) metoda që bazohet në pjesën që zënë në koston totale të vlerësuar, shpenzimet e bëra për punën e kryer deri në një datë të caktuar. Shpenzimet e bëra për punën e kryer deri në atë datë nuk përfshijnë kostot që lidhen me aktivitetin e ardhshëm, të tilla si ato për materiale ose parapagimet. (b) metoda që bazohet në inspektimin e punës së kryer. (c) metoda që bazohet në përfundimin fizik të një pjesë të transaksionit të shërbimit ose punimeve të ndërtimit. Pagesat progresive dhe parapagimet e bëra nga blerësit, shpesh nuk pasqyrojnë punën e kryer.
30	Një njësi ekonomike duhet të njohë shpenzimet që kanë të bëjnë me aktivitete të ardhshme në lidhje me shërbimin ose kontratën e ndërtimit, të tilla si shpenzime për materiale ose parapagimet, si një aktiv, nëse është e mundur që këto shpenzime të rikuperohen.
31	Një njësi ekonomike duhet të njohë si një shpenzim të menjëhershëm çdo kosto që nuk është e mundur të rikuperohet.
32	Kur rezultati i një kontrate shërbimi apo ndërtimi nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme: (a) një njësi ekonomike duhet të njohë të ardhurat vetëm në masën e kostove të kryera të kontratës, të cilat është e mundur të rikuperohen, dhe (b) njësi ekonomike duhet të njohë kostot e kontratës si një shpenzim në periudhën në të cilën ato janë kryer.
33	Në rastet kur kostot totale tejkalojnë të ardhurat totale të një kontrate shërbimi apo ndërtimi, humbja e pritshme do të njihet menjëherë si një shpenzim, kundrejt një provizionit korrespondues për një kontratë në kushte rënduese (shih SKK 6 <i>Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara</i>).
34	Nëse nuk është më i mundur arkëtimi i një shume, të njohur tashmë si e ardhur, njësi ekonomike do ta njohë shumën e paarkëtueshme si një shpenzim në vend që të bëjë një rregullim të shumës së të ardhurave të kontratës.
	Të ardhurat nga kontratat e shërbimeve dhe të ndërtimit
35	Të ardhurat nga kontratat e shërbimeve dhe të ndërtimit përbëhen nga:

	<p>(a) shuma e pagesës fillestare të vendosur në kontratë;</p> <p>(b) ndryshimet në volumin e punës që ndodhin gjatë realizimit të kontratës, kërkesat për zhdëmtim, si dhe pagesat stimuluese-shtesë, vetëm atëherë kur:</p> <p>(i) ato mund të sjellin të hyra për njësinë ekonomike;</p> <p>(ii) mund të maten me besueshmëri.</p>
36	Të ardhurat nga kontratat e shërbimeve dhe të ndërtimit shpesh ndikohen nga ngjarje që ndodhin në të ardhmen, prandaj të ardhurat e vlerësuara të kontratës duhet të rishikohen në çdo datë raportimi. Ndryshime në të ardhurat e kontratës mund të shkaktohen, për shembull nga ndryshimet në qëllimin/shtrirjen e kontratës, tarifat shtesë ose gjobat për përfundime të parakohshme apo të vonuara të projektit, si dhe arsye të tjera të ngjashme me këto.
37	Një ndryshim tipik që ndodh në kontratat e shërbimeve dhe të ndërtimit është ndryshimi i qëllimit/shtrirjes së punës nga ana e klientit që sjell pakësimin ose shtimin e të ardhurave të kontratës. Një ndryshim i tillë përfshihet në të ardhurat e kontratës kur:
	<p>(a) ka mundësi që klienti të miratojë ndryshimet në qëllimin/shtrirjen e kontratës;</p> <p>(b) ndryshimi në të ardhurat e kontratës, që vjen si rrjedhojë e ndryshimit në qëllimin/shtrirjen e punës, mund të matet me besueshmëri.</p>
38	Një kërkesë për zhdëmtim është shuma që pala që ofron shërbimet, kërkon të marrë nga klienti ose një palë tjetër si rimbursim për kostot që nuk ishin parashikuar në çmimin e kontratës. Kjo kërkesë përfshihet në të ardhurat e kontratës kur:
	<p>(a) negociatat me klientët, në lidhje me kërkesën, kanë arritur në atë pikë që pranimi është i mundshëm;</p> <p>(b) shuma që pritet të pranohet nga klienti mund të matet me besueshmëri.</p>
39	Pagesa stimuluese është shuma që klienti është gati të paguajë, nëse disa standarde të specifikuar të performancës janë plotësuar ose tejkaluar nga ofruesi i shërbimeve. Për shembull, një kontratë mund të përmbajë një pagesë stimuluese atëherë kur shërbimi apo ndërtimi përfundon para kohe. Pagesat stimuluese përfshihen në të ardhurat e kontratës kur:
	<p>(a) shërbimet apo punimet e ndërtimit ndodhen në një fazë të tillë të avancuar sa është e mundshme që standardet e specifikuar të performancës të tejkalohen;</p> <p>(b) shuma e pagesës stimuluese mund të matet me besueshmëri.</p>
Kostot e kontratave të shërbimeve dhe të ndërtimit	
40	Kostot e kontratave të shërbimeve dhe të ndërtimit përfshijnë:
	<p>(a) kostot që lidhen drejtpërdrejt me kontratën specifike;</p> <p>(b) kostot e përgjithshme që lidhen me kontratën specifike;</p> <p>(c) kosto të tjera që i ngarkohen në mënyrë specifike klientit.</p>
41	Kostot e kontratave të ndërtimit mund të mos zvogëlohen nga të ardhurat që vijnë si rezultat, për shembull i shitjes së materialeve të tepërta ose i shitjes së pajisjeve dhe makinerive pas kryerjes së shërbimit.
42	Shpenzimet që nuk lidhen në mënyrë direkt me kryerjen e një shërbimi dhe që nuk janë shpenzime të një natyre të përgjithshme, përjashtohen nga kostot e shërbimeve.
43	Kostot e përgjithshme, që lidhen me kontratën e shërbimeve apo të ndërtimit, përfshihen në kostot e kontratës nga data e lidhjes së kontratës deri në përfundimin e saj. Kostot që lidhen direkt me kontratën dhe që janë bërë gjatë procesit për të fituar dhe lidhur këtë kontratë përfshihen gjithashtu në koston e kontratës, nëse ato mund të identifikohen dhe maten më vete me besueshmëri. Kur kostot që lidhen direkt me kontratën dhe që janë bërë gjatë procesit për të fituar dhe lidhur këtë kontratë njihen si shpenzim në një periudhë kontabël, ndërkohë që kontrata lidhet në periudhën kontabël pasardhëse, atëherë këto kosto nuk përfshihen në kostot e kontratës në mënyrë prospektive.
INTERESAT, TË ARDHURAT NGA PËRDORIMI I PRONËS DHE DIVIDENDËT	
44	Një njësi ekonomike njih të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi nga palë të treta i aktiveve të saj që sjellin interes, përfitim pagesash për përdorime të pronës (rojëllti) dhe dividendë mbi bazat e përcaktuara në paragrafin 45 kur:
	<p>(a) është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike, dhe</p> <p>(b) shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme.</p>
45	Të ardhurat njihen si më poshtë:
	<p>(a) të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e brendshme të interesit efektiv (kontabilizimi, në bazë të normës së brendshme të interesit efektiv, përshkruhet gjithashtu në SKK 3, <i>Instrumentet Financiare</i>);</p> <p>(b) të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëllti) njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me kushtet e kontratës;</p> <p>(c) të ardhurat nga dividendët njihen kur aksionari ka të drejtë ligjore për ta arkëtuar atë (dividendin).</p>
PARAQITJA NË PASQYRËN E POZICIONIT FINANCIAR DHE NË PASQYRËN E PERFORMANCËS	

46	<p>Tepricat që rezultojnë nga kontratat e papërfunduara të shërbimeve dhe të ndërtimit duhet të paraqiten si më poshtë:</p> <p>(a) shuma totale e tepricave pozitive të punës në proces përfshihet në aktivet afatshkurtra në një zë më vete në pasqyrën e pozicionit financiar. Këto teprica përfaqësojnë shumat e papaguara nga klientët;</p> <p>(b) shuma totale e tepricave negative të punës në proces përfshihen në detyrimet afatshkurtra brenda grupit të detyrimeve të pagueshme nga aktiviteti dhe detyrime të tjera të pagueshme. Këto teprica përfaqësojnë të ardhura të shtyra dhe duhet të përshkruhen si shuma që njësia ekonomike u detyrohet klientëve;</p> <p>(c) shumat e faturuara klientëve, pagesat e të cilave nuk janë marrë në datën e raportimit paraqiten si kërkesa të arkëtueshme nga aktiviteti.</p>																														
47	<p>Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshin të ardhurat totale të periudhës kontabël.</p>																														
SHËNIMET SHPJEGUESE																															
48	<p>Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, në lidhje me të ardhurat, duhet të paraqitet informacioni i mëposhtëm:</p> <p>(a) politikat kontabël, të përdorura për njohjen e të ardhurave, si dhe metodat e përdorura për përcaktimin e volumit të shërbimeve të kryera (për shembull, njohja e të ardhurave nga kontratat e shërbimeve afatgjata, tarifat e konjeksionit, etj.)</p> <p>(b) shuma e çdo kategorie të rëndësishme të të ardhurave të njohura gjatë periudhës kontabël, duke treguar veçmas të ardhurat që vijnë nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> i) shitja e mallrave dhe e produkteve; ii) kryerja e shërbimeve; iii) interesi; iv) të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëliti); v) dividendët; vi) kontratat e ndërtimit. 																														
49	<p>Një njësi ekonomike, në lidhje me kontratat e ndërtimit, në shënimet shpjeguese duhet të japë informacionet në vijim:</p> <p>(a) shumën e të ardhurave të kontratës të njohura si të ardhura gjatë periudhës.</p> <p>(b) metodat e përdorura për të përcaktuar të ardhurat e kontratës të njohura gjatë periudhës.</p> <p>(c) metodat e përdorura për të përcaktuar fazën e përfundimit të kontratave në proces.</p> <p>(d) shumën bruto të kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët për punë të kontraktuar si një aktiv.</p> <p>(e) shumën bruto të detyrimeve ndaj klientëve për punë të kontraktuar si një detyrim në pasiv.</p>																														
DATA E HYRJES NË ZBATIM																															
50	<p>Ky Standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ky Standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive.</p>																														
KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PER NJËSITE E VOGLA DHE TË MESME(SNRF PËR NVM)																															
51	<p>Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me SNRF për NVM-të. Paragrafët janë trajtuar si korresponduese, nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje, pavarësisht nga fakti që përshkrimet në standardet e referuara mund të kenë ndryshim.</p>																														
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Paragrafët sipas SKK 8</th> <th>Paragrafët sipas SNRF për NVM-të botuar në Korrik 2009</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Paragrafi 1</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 2</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 3</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 4</td> <td>Sek 23.1</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 5</td> <td>Sek 23.2</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 6</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 7</td> <td>Sek 23.4</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 8</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 9</td> <td>Sek 23.3</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 10</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 11</td> <td>Sek 23.5</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 12</td> <td>Sek 23.6</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 13</td> <td>Sek 23.7</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 14</td> <td>Sek 23.8</td> </tr> </tbody> </table>	Paragrafët sipas SKK 8	Paragrafët sipas SNRF për NVM-të botuar në Korrik 2009	Paragrafi 1	Asnjë	Paragrafi 2	Asnjë	Paragrafi 3	Asnjë	Paragrafi 4	Sek 23.1	Paragrafi 5	Sek 23.2	Paragrafi 6	Asnjë	Paragrafi 7	Sek 23.4	Paragrafi 8	Asnjë	Paragrafi 9	Sek 23.3	Paragrafi 10	Asnjë	Paragrafi 11	Sek 23.5	Paragrafi 12	Sek 23.6	Paragrafi 13	Sek 23.7	Paragrafi 14	Sek 23.8
Paragrafët sipas SKK 8	Paragrafët sipas SNRF për NVM-të botuar në Korrik 2009																														
Paragrafi 1	Asnjë																														
Paragrafi 2	Asnjë																														
Paragrafi 3	Asnjë																														
Paragrafi 4	Sek 23.1																														
Paragrafi 5	Sek 23.2																														
Paragrafi 6	Asnjë																														
Paragrafi 7	Sek 23.4																														
Paragrafi 8	Asnjë																														
Paragrafi 9	Sek 23.3																														
Paragrafi 10	Asnjë																														
Paragrafi 11	Sek 23.5																														
Paragrafi 12	Sek 23.6																														
Paragrafi 13	Sek 23.7																														
Paragrafi 14	Sek 23.8																														

	Paragrafi 15	Sek 23.9
	Paragrafi 16	Sek 23.10
	Paragrafi 17	Sek 23.11
	Paragrafi 18	Sek 23.12
	Paragrafi 19	Sek 23.13
	Paragrafi 20	Sek 23.14
	Paragrafi 21	Sek 23.14
	Paragrafi 22	Asnjë
	Paragrafi 23	Sek 23.15
	Paragrafi 24	Sek 23.17
	Paragrafi 25	Sek 23.18
	Paragrafi 26	Sek 23.19
	Paragrafi 27	Sek 23.20
	Paragrafi 28	Sek 23.21
	Paragrafi 29	Sek 23.22
	Paragrafi 30	Sek 23.23
	Paragrafi 31	Sek 23.24
	Paragrafi 32	Sek 23.25, Sek 23.16
	Paragrafi 33	Sek 23.26
	Paragrafi 34	Sek 23.27
	Paragrafi 35	Asnjë
	Paragrafi 36	Asnjë
	Paragrafi 37	Asnjë
	Paragrafi 38	Asnjë
	Paragrafi 39	Asnjë
	Paragrafi 40	Asnjë
	Paragrafi 41	Asnjë
	Paragrafi 42	Asnjë
	Paragrafi 43	Asnjë
	Paragrafi 44	Sek 23.28
	Paragrafi 45	Sek 23.29
	Paragrafi 46	Asnjë
	Paragrafi 47	Asnjë
	Paragrafi 48	Sek 23.30
	Paragrafi 49	Sek 23.31, Sek 23.32
	Paragrafi 50	Asnjë
	Paragrafi 51	Asnjë